



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:121458

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05740549

C.nr.590/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, nëpërmjet gjyqtarit Robert Tunaj, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonit Çoçaj, në çështjen juridike të paditësit R.L nga fshati V. K e S, të cilin me autorizim e përfaqëson av. Xh. B nga P, kundër të paditurës K e S – D e A, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor A. B, me objekt kontesti kompensimi në pagë konform licencimit – kualifikimit dhe shkallës së inflacionit, gjykata me datë 27.05.2024, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit R. L, me të cilën **DETYROHET** e paditura K e S – D e A, që në emër të kompensimit në pagë konform licencimit dhe shkallës së inflacionit, të paguajë shumat dhe atë:

Në emër të kompensimit lidhur me licencimin – kualifikimin, për periudhën kohore 14.06.2019 – 21.11.2022, shumën prej 2,269.35 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë (14.06.2022);

Në emër të kompensimit lidhur me shkallën e inflacionit, për periudhën kohore 29.11.2020 – 11.01.2021, shumën prej 6.35 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së ndryshimit të padisë (29.11.2023)

Të gjitha këto në shumë totale **2,275.70€ (dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë e shtatëdhjetë euro)**, deri në pagesën definitive,

në afat prej 7 ditësh, pas plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë sa i përket licencimit për periudhën kohore 17.03.2017 – 13.06.2019, në shumën prej 1,494.45€, si dhe në emër të kompensimit për diferencën së papaguar në pagë, referuar normës së inflacionit për periudhën 18.04.2017 - 29.11.2020, në shumën prej 345.76 €, për shkak të parashkrimit,

III. Hedhet poshtë e palejuar padia dhe kërkesëpadija për shumën prej 809.58 € për periudhën kohore 11.01.2021 deri më 22.11.2022 si gjë e gjykuar.

IV. OBLIGOHET e paditura K e S, që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 229.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate me 14.06.2022, ka parashtruar padi me numër C.nr.590/22, kundër K së S, D e A, me të cilën ka kërkuar kompensim në pagë, lidhur me kualifikimin – licencimin, për periudhën kohore 18.04.2017 – 18.04.2021, në shumën prej 3,408.48 euro.

I njëjti, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate, me datë 29.11.2023, ka parashtruar parashtresën me numër C.nr.590/22, me të cilën ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin objektiv. Konkretisht, ka kërkuar që në emër të kualifikimit – licencimit të zgjerohet periudha kohore prej datës 17.03.2017 – 21.11.2022, si dhe është rritur shumën në 4,758.34 euro. Gjithashtu, përmes kësaj parashtrese ka kërkuar nga ana e gjykatës që paditësit ti njihet e drejta e kompensimit në pagë referuar normës së inflacionit dhe atë për periudhën kohore 18.04.2017 – 21.11.2022, në shumën prej 1,092.16 euro. Shpenzimet gjyqësore i ka kërkuar në shumën prej 229 euro.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës, me datë 09.02.2024 pranë kësaj gjykate ka parashtruar përgjigje në padi, me numër C.nr.590/2022, me të cilën ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditëses lidhur me kompensimin e pagës, konform licencimit – kualifikimit, pasi që në

rastin konkret paditësja ka nënshkruar kontratën e punës, në të cilën janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e palëve nënshkruese, duke përfshirë edhe pagën. Andaj, sipas tij të gjitha obligimet që dalin nga kontrata e punës, këtu e paditura i ka përmbushur, duke llogaritur edhe çështjen e gradimit. Gjithashtu, ka theksuar se kërkesa e paditësit në rastin konkret është e pabazë, ngase nuk posedon licencë valide të mësimdhënies. Gjithashtu, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, i njëjti ka theksuar se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e **themeltë**, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në SH.F.M.U. “Dëshmorët e Kombit”, në fshatin V, K e S.

Këtë fakt, gjykata e vërtetoi përmes provave dhe atë:

Në bazë të kontratës me numër protokollit 05Nr.127/3, e datës 04.09.2018, e lëshuar në emër të paditësit Ramiz Loshi, me të cilën evidentohet fakti se i njëjti është mësimdhënës në këtë shkollë, si mësimdhënës lëndor, me kualifikim Bachelor në Biologji, me pagë mujore prej 421 euro, si dhe në emër të gradimit, kompensimi në shumën prej 58.32 euro.

Në bazë të licencës me numër 100010691, në emër të paditësit, evidentohet fakti se e njëjta nuk është valide, sepse afati i validitetit të saj ka qenë nga data 01.03.2013 – 01.03.2018.

Në bazë të listës së pagave me numër 10-93340-624-0912, pagesa e muajit tetor 2021, evidentohet nëpunësi R. L, me numër EM00011898, me pagë bazë 421 euro, si dhe kompensimi në shumën 58.32 euro në emër të kualifikimit – fakultet.

Gjykata, me rastin e aprovimit të pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit dhe përcaktimit të lartësisë për kompensimin e diferencës në pagë për punonjësit me licencim-kualifikim, është bazuar në Kontratën Kolektive

të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, e nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33, të datës 29.08.2008.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika 3 dhe pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvjeçar, 27 % e pagës bazë.*

Gjithashtu, në bazë të kontratës kolektive të arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, në nenin 7 për licencim thuhet se: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e licencës së fituar, bazuar në UA Nr. 5/2017 Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale, si vijon: 1.1 Mësimdhënës me Licencë të karrierës 10 % e pagës bazë. 1.2 Mësimdhënës me Licencë të avancuar 10% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me Licencë mentor 15% e pagës bazë. 1.4 Mësimdhënës me Licencë meritor 15% e pagës bazë”.-+*

Në vendimin e Qeverisë Nr.01/33, të datës 29.08.2008, në paragrafin 4 pika 2 dhe 3, përcaktohet se *“Mësimdhënësit me Diplomë Universitare 3 dhe 4 vite fitojnë ngritje të pagës bazë për 27%.*

Edhe në bazë të Mendimit Juridik, me nr.prot.214/2013, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues, për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën Komunën e Suharekës.

Gjithashtu, gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, që të ia kompensoj diferencën e pa paguar në pagë, referuar

normës së inflacionit për vitin 2020 - 0.2 %, për vitin 2021 - 3.4 % dhe vitin 2022 - 11.6 %, duke u bazuar në dispozitat e nenit 35, pika 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, që parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit në bazë të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës”*.

Sa i përket shkallës së inflacionit nëpër vite, gjykata vendosi si më lartë duke u bazuar konform tabelës së inflacionit të lëshuar nga parashtrësja e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023.

Duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, si dhe dispozitave tjera ligjore dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e aprovoj në mënyrë të pjesshme kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyroi të paditurën, që t’ia paguaj shumën monetare për periudhën kohore 14.06.2019 – 21.11.2022, shumën prej 2,269.35 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë (14.06.2022).

Kjo vlerë ka ardhur duke llogaritur në bazë të formulës: Paga bazë 421€ * 27% e pagës bazë është 113.67€ - 58.32€ diferenca e paguar në pagë = 55.35 x 41 muaj, gjithsej = 2,269.35 euro.

Ndërkaq, gjykata vendosi lidhur me shumën në emër të kompensimit lidhur me shkallën e inflacionit, duke llogaritur për periudhën kohore nën marrëdhënie të punës për paditësin dhe secilin vit, marrë për bazë shkallën e inflacionit, ashtu që, për periudhën kohore 29.11.2020 – 11.01.2021, shumën prej 6.35 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së ndryshimit të padisë (29.11.2023), ndërsa hedhet padia për shuma prej 809.58 € për periudhën kohore 11.01.2021 deri më 22.11.2022 si gjë e gjykuar pasi që me vendimin-aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë, evidentuar me numër **C.nr.1102/22 të datës 09.01.2024** është vendosur për shumën në emër të kompensimit lidhur me shkallën e inflacionit.

Andaj, lidhur me këtë gjykata ka vendosur duke u bazuar në formulën: Për periudhën kohore 29.11.2020, deri 31.12.2020, për shkallën e inflacionit 0.2 %, shumëzuar me pagën bazë 421.20 euro, është 0.85 euro, shumëzuar me 1 muaj, shuma e përgjithshme prej 0.85 euro;

Për vitin 2021, shkalla e inflacionit 3.4 %, shumëzuar me pagën bazë 421.20 euro, është 14.30 euro, shumëzuar me 11 ditë , shuma e përgjithshme prej 5.50 euro;

Të gjitha këto në shumë totale **2,275.70€ (dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë e shtatëdhjetë euro)**, deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas plotëfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh afatin e parashkrimit për kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen në afat prej 3 vitesh, konkretisht në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Andaj, gjykata vendosi që të refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë sa i përket licencimit për periudhën kohore 17.03.2017 – 13.06.2019, në shumën prej 1,494.45€, si dhe në emër të kompensimit për diferencën së papaguar në pagë, referuar normës së inflacionit për periudhën për vitin 2017, 2018, 2019, deri 29.11.2020, në shumën prej 345.76 €, për shkak të parashkrimit, ndërsa shuma prej 809.58 € për periudhën kohore 11.01.2021 deri më 22.11.2022 është refuzuar si gjë e gjykuar pasi që me aktgjykimin **C.nr.1102/22 të datës 09.01.2024** është vendosur për shumën në emër të kompensimit lidhur me shkallën e inflacionit.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë 104.00, ndryshimit të padisë shumën prej 104.00 euro, si dhe në emër të taksës gjyqësore 21 euro, në shumën e përgjithshme të shpenzimeve gjyqësore prej 229.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.590/22, dt.27.05.2024**

Gjyqtari

Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.